Një listë e gënjeshtrave, shtrembërimeve dhe trillimeve të përhapura në rrjetet sociale nga Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī.

قائمة الأكاذيب والافتراءات والتحريفات نشرها الدكتور عرفات المحمدي وأتباعه عبر مواقع التواصل الاجتماعي

Shënim: Ky artikull u shkrua në prill të vitit 2025, por nuk u publikua deri në dhjetor të vitit 2025. Që nga ajo kohë, brenda vetëm rreth një muaji, ʿArafāt al-Muḥammadī është demaskuar dhe vertetuar si gënjeshtar nëpërmjet shumë mënyrave të tjera. Përveç kësaj, ai është demaskuar edhe për komplotin e tij për të gënjyer kundër Shejh Rabīʿ-it, me qëllim që të merrte një **fetva** të favorshme që do të justifikonte **khurūj** (kryengritjen/rebelimin) kundër autoritetit legjitim në Jemen, si dhe për fshehjen e fetvasë së qartë të Shejhut mbi këtë çështje. Ai vazhdon të demaskohet dita-ditës, me gjithnjë me më shumë turpërime dhe skandale.

Hyrje

Shejh al-Islām **Ibn Tejmije** (Allahu e mëshiroftë) ka thënë:[1]

"Të folurit për njerëzit duhet të bëhet me dije dhe drejtësi, e jo me injorancë dhe padrejtësi, ashtu siç është gjendja e njerëzve të bidatit (risive në fe)."

Ai gjithashtu ka thënë:[2]

"Njeriu i drejtë (ʿadl) është ai që e përcjell një çështje ashtu siç është; nuk i shton asgjë, duke u bërë kështu gënjeshtar, dhe nuk i heq asgjë, duke u bërë fshehës i së vërtetës."

Shejh **Rabīʿ bin Hādī** ka thënë:[3]

"Sa i përket kritikës dhe atyre që merren me të, Allahu e ka bërë Ehli Sunetin dhe Xhematin të pastër nga mbështetja në gënjeshtra dhe padrejtësi, si edhe nga animi i

padrejtë (qoftë në favor të Ehli Sunetit apo të të tjerëve), sepse animi i verbër dhe fanatizmi ndaj personave nuk gjendet veçse te njerëzit e devijimit dhe të deshirave."

Ai gjithashtu ka thënë:[4]

"Metodologjia (menhexhi) selefije është e ndërtuar mbi Librin e Allahut dhe Sunetin, si dhe mbi drejtësinë, paanshmërinë, maturinë dhe ekuilibrin në të gjitha fushat e fesë. Ndërsa padrejtësia, devijimi, humbja e rrugës dhe tejkalimi i kufijve në gjykime gjenden te kundërshtarët e saj."

Konteksti

Gjatë viteve **2023** dhe **2024**, u bë gjerësisht e njohur për shumicën e popullsisë së botës se reagimi ndaj **COVID-19** ishte i ekzagjeruar, në mos krejtësisht mashtrrim; dhe ai shërbeu si një skemë për të shitur injeksione eksperimentale (siç u shpreh edhe Shejh al-Luḥajdān në një ngjarje të ngjashme); se këto injeksione u promovuan me ane te mashtrrimit, rezultuan të pasuksesshme (pavarësisht propagandës që pretendonte të kundërtën) dhe shkaktuan shumë vdekje dhe lëndime. Megjithëse gjendja e emergjencës pandemike ishte planifikuar të zgjaste pesë vjet, ajo u ndërpre në maj të vitit **2023**, për shkak të ndërgjegjësimit të publikut dhe humbjes së besimit në injeksionet dhe dozat përforcuese (booster). Ndërsa këto ndergjegjesime po përhapeshin, disa njerëz mbetën të pakënaqur, sepse ishin angazhuar më parë në qëndrime dhe gjykime të ashpra, të cilat nuk buronin nga dijetarët e mëdhenj të emëruar zyrtarisht nga qeveria.

Pika vendimtare erdhi më **17 shtator 2024**, kur publikova në **X (Twitter)** një link drejt një raporti të bazuar në disa deklarata të Shejh ʿ**Alī al-Ḥudhayfīt** lidhur me "reduktimin e popullsisë dhe vaksinat". Kjo me shum mundesi solli zemërimin e Dr. ʿ**Arafāt al-Muḥammadī** për dy arsye. Së pari, për shkak të vetë temës ne fjale. Deri aq vone sa **gusht 2023**, ai vazhdonte të akuzonte në mënyrë të rreme të tjerët se gënjenin (https://abuiyaad.com/d/arafat-indonesia-vax-deaths-lie) kur thoshin se vaksinat kundër COVID-19 shkaktonin vdekje dhe pasoja shendetesore. Së dyti, ai kishte mosmarrëveshje me Shejh ʿ**Alī al-Ḥudhayfīn**, dhe ka të ngjarë të jetë pikelluar dhe merzitur nga artikulli mbi vaksinat dhe kontrollin e popullsisë; Allahu e di më së miri.

https://abuiyaad.com/r/population-control-vaccines/p/7 (fjalimi i sheikh Ali al hudhaifit)

Dy ditë më vonë, i nxitur nga disa gra të njohura për krijimin e fitnes (përçarjes) në fushën e da'ues (thirrjes islame), të cilat vepronin me identitete të fshehura në rrjetet sociale, ai filloi të bënte akuza dhe sulme të drejtuara ndaj meje, duke përdorur një gjuhë që e bënte të qartë se kujt i drejtoheshin.

Çfarë ndodhi shkurtimisht

Gjatë shtatorit 2024, Dr. ʿ**Arafāt al-Muḥammadī** përhapi në rrjetet sociale një sërë akuzash ndaj meje, të bazuara në disa mesazhe zanore private të miat nga maji i vitit 2021, duke përdorur

gjuhë që e bënte të qartë identitetin tim. Këto akuza ishin ose gënjeshtra dhe trillime të pastra, ose shtrembërime, ose keqinterpretime të fjalëve dhe fjalive të shkëputura nga konteksti, të zgjatura, të deformuara ose të përgjithësuara, në mënyrë që të krijohej përshtypja se unë i urreja dijetarët dhe dëshiroja t'i rrëzoja ata.

Meqenëse bëhej fjalë për një regjistrim zanor privat, të dërguar vetëm një personi, kjo çështje mund të ishte zgjidhur shumë lehtë. Gjithçka që ai duhej të bënte ishte të më kontaktonte privatisht dhe të kërkonte sqarim, duke thënë: *"Ekziston një regjistrim privat i yti në të cilin disa prej deklaratave të tua janë kuptuar dhe interpretuar në këtë mënyrë. A është kjo e saktë dhe a mund ta shpjegosh?"* Kaq mjaftonte. Megjithatë, sipas autorit, Dr. ʿ**Arafāt al-Muḥammadī** dëshironte të krijonte një skandal dhe, për këtë arsye, e çoi çështjen në rrjetet sociale.

Arafati nuk respektoi asnjëherë integritetin intelektual dhe akademik, por bëri akuza të egra, tronditëse dhe tepër të ekzagjeruara, duke besuar gënjeshtrat e përkthyesve të tij. Më pas, ai refuzoi të trregonte burimet dhe përkthyesit e tij. Kur nuk ishte në gjendje të provonte pretendimet e tij, ai kërkoi **pajtim (ṣulḥ)** dhe **arbitrazh/gjykim (muḥākamah)** në mënyrë jo publike nga mbrapa skenave, e cila ishte vetem nje komplot për të dalë nga kjo situatë e vështirë.

Më pas, disa muaj më vonë, pasi rishikoi taktikat e tij dhe u përpoq të përmirësonte imazhin e vet, ai filloi një fushatë më të fshehtë dhe më dinake. Ai përdori persona të tjerë si ndërmjetës për të kryer punën e tij, me synimin për ta ringjallur edhe një herë këtë çështje dhe për të përdorur metoda si provokimi në internet (trolling), frikësimi dhe bullizimi. Kjo është ajo që ka ndodhur gjatë dy muajve të fundit, që prej **shkurtit 2025**.

Kjo nuk është mënyra e veprimit të dijetarëve, të cilët synojnë të përmirësojnë, të korrigjojnë dhe të bashkojnë njerëzit. Përkundrazi, kjo sjellje eshte metoda e **Ḥaddādijve**, qe qellimin e tyre paresor e kane është të shkatërrojnë, të përçajnë dhe të ndajnë njerëzit. Kjo nuk është mënyra se si duhet të trajtohen selefitë .Dhe është ngushelluese që shumica dërrmuese e selefive në botën anglishtfolëse e kanë kuptuar këtë.

Çfarë përmbajnë mesazhet zanore

Çështjet për të cilat fola, qoftë në këto mesazhe zanore apo në raste të tjera, ishin një përgjigje ndaj pretendimeve të pasakta dhe ekzagjerimeve të bëra nga disa student te dijes , si dhe ndaj atribuimeve të rreme që ata ua bënin dijetarëve gjatë periudhës së operacionit të COVID-19.

Disa prej tyre pretendonin se rregullat dhe politikat e **Arabisë Saudite** duhej të zbatoheshin edhe në vendet tona dhe në xhamitë tona këtu në Perëndim, edhe nëse autoritetet shëndetësore të këtyre vendeve nuk e kërkonin një gjë të tillë. Po kështu, disa argumentonin se, meqenëse disa dijetarë e kishin marrë vaksinën, atëherë të gjithë ne duhej ta merrnim gjithashtu; përndryshe, kjo do të nënkuptonte fyerje ose nënçmim ndaj dijetarëve. Gjithashtu, disa pretendonin se mjekët, studiuesit dhe specialistët myslimanë kudo në botë nuk lejoheshin të diskutonin çështje mjekësore dhe shkencore (brenda fushës së tyre të specializimit), përveçse pasi t'ua paraqisnin ato fillimisht dijetarëve të mëdhenj. Duhet theksuar se asnjëra prej këtyre gjërave nuk ishte thënë

nga dijetarët e mëdhenj por njerëzve po u krijohej përshtypja sikur këto pretendime vinin drejtpërdrejt prej tyre.

Këto janë çështjet që përmenda në mesazhet zanore, të cilat zgjasin rreth **55 minuta**:

- Se mjekët, specialistët, autoritetet shëndetësore dhe shtetet kanë pasur dallime të mëdha në lidhje me reagimin ndaj pandemisë COVID-19.
- Se autoriteti i një shteti nuk shtrihet mbi shtetet e tjera dhe se çdo person është vetem i detyruar të respektojë vetëm ligjet e vendit të tij.
- Megjithatë, kur dispozitat fetare nuk janë të qarta për ne, duhet t'u drejtohemi dijetarëve.
- Se duhet t'u bindemi sundimtarëve dhe dijetarëve në çështjet ku ata kanë ushtruar **ixhtihad** (arsyetim juridik të pavarur).
- Se dijetarët bëjnë thirrje për bindje ndaj sundimtarëve në ixhtihadet e tyre, në përputhje me Sunetin.
- Se askush nuk mund të detyrohet të mbajë një mendim në mjekësi (ose në çështje fetare ku ekziston mospajtim) kundër bindjes së tij personale.
- Se mjekët dhe studiuesit janë të lirë të diskutojnë dhe debatojnë pikëpamje nga aspekti mjekësor dhe shkencor dhe se askush nuk ka të drejtë t'i heshtë ata.
- Se në çdo fushë të specializuar të jetës (si mjekësia, teknologjia, industria ose bujqësia), nuk është detyrë e dijetarëve islamë të zgjidhin mosmarrëveshjet ndërmjet specialistëve të asaj fushe.
- Se ne mund t'i këshillojmë sundimtarët përmes mënyrave të ligjësuara nga feja.
- Se, nëse dëshirojmë të sjellim ndryshim, duhet t'u japim këshillë autoriteteve shëndetësore dhe ministrave në mënyrën e ligjësuar.
- Një vëzhgim i rastësishëm lidhur me zhvillimin e shpejtë të shteteve arabe të Gjirit, i cili mbështetet në masë të madhe në ekspertizën e huaj.

Megjithatë, të gjitha këto u shtrembëruan dhe me paraqiten mua si një person që urren dijetarët, dëshiron t'i rrëzojë ata dhe ndjek metodologjinë e **Muʿtezilëve**, **Kutbijëve** dhe **Sururijëve** në qëndrimin ndaj tyre. Duke përdorur vetëm **8 minuta** nga regjistrimi zanor (dhe duke lënë jashtë **45 minutat** e para), ata me atribuan mua gjëra që nuk i kam thënë dhe nuk i kam pasur për qëllim, ndërsa fjalëve të mija i dhane interpretimin më te keq te mundshëm.

Mënyra e dijetarëve: Ndershmëria, integriteti dhe sinqeriteti

Sa u përket standardeve të **sinqeritetit**, **ndershmërisë**, **integritetit** dhe **besueshmërisë** që duhet të shfaqen në shkrime, kritika dhe kundërpërgjigje (refutime), ja një shembull në lidhje me Shejh **Rabīʿ bin Hādī** dhe kundërpërgjigjet e tij ndaj **Sejjid Kutbit**:[5]

"Nga shenjat e sinqeritetit të tij – Allahu e ruajtë – janë kundërpërgjigjet e tij të besueshme ndaj njerëzve të deshirave dhe bidatit (risive në fe). Ai nuk trillon, nuk falsifikon dhe nuk u atribuon atyre gjëra të pavërteta. Ai më tregoi – Allahu e ruajtë – se një herë rreth pesëmbëdhjetë burra nga el-Kasimi erdhën tek ai dhe i thanë:

'Ne kishim rënë dakord mes nesh që t'i refutonim librat e tu kundër Sejjid Kutbit. I mblodhëm dhe filluam t'i shqyrtonim, ndërkohë që në mendjet tona ishte ngulitur ajo që

kishim dëgjuar: se ti i shkëput tekstet nga konteksti dhe gënjen ndaj Sejjid Kutbit. Kështu, filluam të krahasonim, fjalë për fjalë, atë që ti kishe cituar prej tij. Nuk gjetëm se kishe lënë pa përfshirë as edhe një presje. Atëherë e kuptuam se e vërteta ishte me ty dhe të kërkojmë falje.'"

Ky është standardi i **integritetit** dhe **ndershmërisë** që tregohet edhe ndaj një bidatciu të devijuar, i cili kishte gabime të mëdha në besim dhe metodologji.

Tani, le të shohim integritetin dhe ndershmërinë e **Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī** në raport me thirrësit në **Teuhid** dhe **Sunet**, të cilët, sipas tij, kanë mbrojtur nderin dhe pozitën e dijetarëve të mëdhenj të këtij umeti për dekada të tëra, gjatë shumë sprovave dhe trazirave.

Lista e gënjeshtrave, shtrembërimeve, trillimeve dhe shpifjeve të Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī

Më poshtë gjendet një listë e gënjeshtrave, shtrembërimeve dhe trillimeve të ndryshme që u përhapën nga Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī përmes llogarive të tij në rrjetet sociale, të cilat së bashku arrijnë mbi 100,000 ndjekës. Këto deklarata u përkthyen gjithashtu nga ndjekësit e tij në anglisht, gjermanisht, urdu dhe gjuhë të tjera, e më pas u shpërndanë gjerësisht në rrjetet sociale.

Vlen të theksohet se disa prej akuzave të mëposhtme u paraqitën nga Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī me fjalët **"thotë"** (يقول) dhe **"pretendon"** (يزعم). Fjala **يزعم** në arabisht mund të ketë kuptimin **"tha"** (قال), **"përmendi"** (ذكر), **"besoi"** (ظن), **"mendoi"** (اعتقد) ose **"ishte i bindur"** (استيقن). Prandaj, kjo përbën një atribuim të qartë se dikush ka thënë, besuar ose ka qenë i sigurt për një çështje të caktuar.

---

01. "Dijetarët e mëdhenj janë beduinë të shkretëtirës që nuk janë të aftë."

علامء الكبار بدو أهل صحراء ال حيسنون

Realiteti: Ky është një trillim i pastër.

Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī ma atribuoi mua këtë deklaratë dhe tha se unë e pretendoj një gjë të tillë. Megjithatë, kjo nuk gjendet askund në regjistrimet e mia zanore; është një gënjeshtër e paster.

Ai dhe ekipi i tij i përkthyesve kanë përzier gjërat së bashku fakti qe unë kam thënë se dijetarët nuk zgjidhin mosmarrëveshjet mjekësore midis njerëzve, sepse kjo nuk është fusha e tyre e specializimit dhe se ata vetë i drejtohen specialistëve për çështje të tilla.

Gjithashtu, kam përmendur rastesisht se shtetet arabe të Gjirit janë relativisht të reja në fushën e shkencës dhe mjekësisë moderne; ato lanë jetën tradicionale të shkretëtirës dhe u zhvilluan me shpejtësi falë pasurisë së naftës, dhe jane shume te varura në ekspertizën e huaj nga Evropa dhe Amerika. Për këtë arsye, përvoja e tyre në mjekësinë moderne është relativisht e re.

Pra ata i bashkuan të gjitha këto deklarata dhe më atribuan fjalë që unë nuk i kam thënë, nuk i kam pasur për qëllim dhe as nuk i kam menduar ndonjëherë. Ky është një trillim i tmerrshëm.

---

02. "Ata (dijetarët e mëdhenj) ndjekin sundimtarët e tyre me një pasim të verbër."

وينقادون)أي العلامء الكبار(خلف والة أمرهم بتبعية عمياء

Realiteti: Ky është një trillim dashakeq.

Unë kam deklaruar se kur sundimtari bën **ixhtihad** (gjykim të pavarur juridik në çështje ku ka mospajtime), veçanërisht në kuadër të një ngjarjeje ndërkombëtare, dijetarët do të mbështesin politikat shëndetësore të sundimtarit nga këndvështrimi i Sunetit, edhe nëse mund të kenë mendime personale të ndryshme.

Një shembull është qëndrimi i Shejh ʿUbayd (Allahu e mëshiroftë) lidhur me distancimin fizik, si dhe mendimi i Shejh ʿAbd al-Muḥsin al-ʿAbbād (Allahu e ruajttë) mbi vlefshmërinë e namazit me boshllëqe ndërmjet safëve.

https://abuiyaad.com/a/ubayd-social-distancing-prayer/print (sheikh Ubejd el jabere rreth distancimit fizik)

Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī i ka shtrembëruar këto fjalë dhe ka trilluar një gënjeshtër ndaj meje, duke më atribuar fjalë që nuk i kam thënë kurrë.

---Ja disa shembuj nga regjistrimet e mia zanore:

"Shkurtimisht, çfarëdo që dijetarët kanë këshilluar për atë vend, për Arabinë Saudite, unë bëj thirrje për bindje ndaj sundimtarëve. Kështu, mospajtimi ka përfunduar. Tashmë nuk kemi asnjë mosmarrëveshje për bindjen ndaj sundimtarëve dhe dijetarëve."

"Pra, nga këndvështrimi i Sunetit, thjesht sepse e duam Sunetin dhe bëjmë thirrje drejt tij, ne u kërkojmë njerëzve t'u binden sundimtarëve."

"E kam bërë të qartë se, nga ana praktike, duhet t'i bindesh sundimtarit të vendit tënd për çdo masë që ai vendos. Edhe nëse nuk pajtohesh me ato masa, duhet t'i bindesh, sepse kjo është ajo që kërkon Suneti."

"Çfarë thonë dijetarët në Arabinë Saudite? Kthehuni tek ata…. Ata po thonë: ndiqni atë që thonë sundimtarët.apo jo? Prandaj, në përputhje me parimin e Sunetit, dhe unë them: Ndiqni sundimtarët dhe dijetarët."

Kushdo që dëgjon këto deklarata të mia të qarta në regjistrimet zanore, të përsëritura vazhdimisht, dhe më pas më akuzon se kam thënë se dijetarët "ndjekin sundimtarët me pasim të verbër", vetëm sepse kam thënë se në çështjet e ixhtihadit që lidhen me mjekësinë ata do t'u binden sundimtarëve, nuk mund të jetë aspak njeri i sinqertë.

Nëse unë do të kisha thënë se "dijetarët ndjekin sundimtarët me pasim të verbër", atëherë përse në regjistrim e përsëris rreth dhjetë herë se duhet t'u bindemi sundimtarëve për shkak të Sunetit dhe sepse kjo është ajo që kërkojnë vetë dijetarët?

Shihni gjithashtu pikën 8 më poshtë.

حينام تريد تنرص فكرة باطلة فالبد أوال أن تسقط مكانة العلامء

03. "Kur dëshiron të përhapësh një ide të rreme, së pari duhet të rrëzosh pozitën e dijetarëve."

Realiteti: Kjo është një akuzë për bidat (risi në fe).

T'ia atribuosh dikujt – aq më tepër një selefiu – dëshirën për të rrëzuar dijetarët e Teuhidit dhe Sunetit me qëllim përhapjen e një ideje të rreme, nuk mund të jetë gjë tjetër veçse devijim i bazuar në urrejtje ndaj dijetarëve.

Kjo akuzë, së bashku duke me krahasuar mua vazhdimisht me Sururijtë dhe Kutbijtë, si dhe akuzat për devijim, len te nekuptoje shpalljen ndaj meje si bidatçi (tabdi'). Kjo nuk është mënyra se si trajtohet një pasues i Sunetit.

Përkundrazi, në ditët e para të pandemisë COVID-19, unë mbrojta sundimtarët kundër akuzave të Sururijve dhe Kutbijve, të cilët i fyenin sundimtarët për vendosjen e masave kufizuese.

Kjo mbrojtje përfshinte së pari sqarimin e detyrimit për të dëgjuar dhe për t'iu bindur sundimtarit mysliman, gjë që e kam përmendur shumë herë, madje edhe në regjistrimin që ata përdorën kundër meje. Kjo është akideja ime dhe akideja e Ehil Sunetit.

Së dyti, kam përmendur se sundimtarët myslimanë kanë të drejtë të bëjnë ixhtihad dhe mund të vendosin masa për arsye të ndryshme, duke perfshire por jo te limituara nga marreveshjet nderkombetare .

Sa u përket dijetarëve, unë vazhdimisht kam këshilluar që njerëzit t'u drejtohen atyre dhe kam pohuar të drejtën e tyre për të bërë ixhtihad dhe për të dhënë fetva lidhur me adhurimet dhe transaksionet e ndikuara nga masat e pandemisë. Edhe në regjistrimin që u përdor kundër meje, e kam përmendur disa herë se për çështjet që kërkojnë vendim fetar duhet t'u drejtohemi dijetarëve.

Prandaj, nëse unë paskam dashur të rrëzoj dijetarët për të përkrahur një ide të rreme, atëherë cila ishte ajo ide e rreme dhe cilët dijetarë konkretisht kam dashur të rrëzoj? Ju lutem, përmendini me emër….

العلامء ال يستطيعون خمالفة سياسة حكامهم وعيل هذا: أفتوا يف التطعيامت بام أراد حكامهم

04. "Dijetarët nuk janë në gjendje të kundërshtojnë politikat e sundimtarëve të tyre; prandaj dhanë fetva në favor të vaksinimeve sipas dëshirës së sundimtarëve."

Realiteti: Ky është një trillim i pastër.

وقد سمعت صوتية ألحدهم وهو يسفه قول العلامء الذين أفتوا باجلواز

05. "Kam dëgjuar një regjistrim të njërit prej tyre, ku ai e quan të pamend mendimin e dijetarëve që dhanë fetvanë e lejueshmërisë (së injeksioneve)."

Realiteti: Ky është një trillim i pastër.

Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī as nuk flet anglisht. Për më tepër, si mund të ketë dëgjuar diçka që unë nuk e kam thënë kurrë, në një gjuhë që ai vetë nuk e kupton?

Prandaj, Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī po gënjen haptazi në këtë rast.

Dijetarët dhanë një gjykim fetar (ḥukm sharʿī), dhe unë e kam pranuar këtë, sepse mosmarrëveshja nuk kishte të bënte kurrë me pyetjen nëse vaksinat në përgjithësi ose ky injeksion specifik kundër COVID-19 ishin të lejueshme (xha'iz).

Përkundrazi, unë fola për këto injeksione nga pikëpamja mjekësore dhe shkencore, duke u mbështetur në fakte konkrete dhe realitete të vërtetuara, ashtu siç bënë mijëra specialistë dhe studiues të tjerë në fushën e mjekësisë në mbarë botën.

أفتوا يف التطعيامت بام أراد حكامهم

06. "Ata dhanë fetva për vaksinimet sipas dëshirës së sundimtarëve të tyre."

Realiteti: Shtrembërim, trillim dhe shpifje e hapur.

Sic e shihni mund të shihet qartë dëshpërimi i Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī në përpjekjen për ta paraqitur fjalën time sikur buron nga metodologjia e Kutbijve dhe Sururijve, të cilët pretendojnë se dijetarët janë "skllevër të sundimtarëve". Kjo është një nga format më të liga të shtrembërimit.

Duke qenë se, në fillim të vitit 2021 injeksionet eksperimentale po shkaktonin dukshëm vdekje dhe dëmtime shendetesore tek njerëzit, dëshiroja të mbroja dijetarët duke sqaruar se ata nuk i hartuan dhe as nuk i imponuan politikat e vaksinimit.

Përkundrazi, ata vetëm folën për lejueshmërinë e marrjes së ilaçeve parandaluese dhe u ndalën me kaq. Në mënyrë më të përgjithshme, ata mbështesin masat shëndetësore të qeverisë dhe nuk i kundërshtojnë ato, nga këndvështrimi i bindjes ndaj sundimtarit dhe ruajtjes së rendit në shoqëri.

إن العلاماء اليستطيعون خمالفة سياسة حكامهم

07. "Dijetarët nuk janë në gjendje të kundërshtojnë politikën e sundimtarëve të tyre."

لهنم ال جيرؤون أن خيالفوا سياسة حكامهم، وال خيرجون عن حكمهم

08. "Sepse ata nuk guxojnë të kundërshtojnë politikën e sundimtarëve të tyre dhe nuk dalin jashtë vendimeve të tyre."

Realiteti: Siç mund ta shohë qartë lexuesi, Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī po përdor shumë manipulime logjike dhe po shtrembëron rëndë fjalët.

Çështja është e thjeshtë. Kur sundimtarët bëjnë **ixhtihad** gjatë një ngjarjeje që konsiderohet krizë, veçanërisht në çështje ku ekzistojnë mendime të ndryshme, dijetarët do të mbështesin politikat shëndetësore dhe nuk do t'i kundërshtojnë ato, edhe nëse personalisht mund të kenë një mendim tjetër. Kjo bëhet nga këndvështrimi i përmbajtjes ndaj Sunetit.

Ja fjalët e Shejh ʿAbd Allāh al-Bukhārī më 30 nëntor 2021, kur fliste për masat e pandemisë dhe injeksionet kundër COVID-19:

وأنا أتكلم عن أهل بلدي والذين جيب الوثوق فيهم وال جيوز اخلروج عن رأهيم ألمر ويل األلمر بطاعته يف غري معصية فهذا ويل األلمر قد أوكل األلمر إليهم... كيف يل أن أترك قوهلم.

"Unë po flas për njerëzit e vendit tim, tek të cilët është detyrim të kemi besim. Nuk lejohet të dalim jashtë mendimit të tyre, për shkak të urdhrit për t'iu bindur sundimtarit në gjërat që nuk janë mëkat. Sundimtari ua ka besuar atyre këtë çështje... Si mund ta braktis une mendimin e tyre?"

Në këto fjalë Shejh ʿAbd Allāh al-Bukhārī tha se nuk mund të ketë një mendim jashtë mendimit të tyre dhe nuk mund ta braktisë atë që ata thonë.

Kjo deklaratë sic vihet re është shumë më e lehtë të interpretohet si "dijetarët ndjekin verbërisht sundimtarët dhe nuk do t'i kundërshtojnë kurrë politikat e tyre" sesa deklaratat e mija. Megjithatë, kushdo që lexon fjalët e mija e kupton qartë se çfarë ishte për qëllim.

Ketujane fjalet e mija fikse nga një regjistrim audio prej tetë minutash, të përdorur nga Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī:

"Në përgjithësi, reagimi që kam marrë është se që dijetarët thjesht do të thonë është t'u bindeni sundimtarëve; ndoshta merreni vaksinën nëse ju ofrohet. Ata nuk do të thonë asgjë që kundërshton politikën e sundimtarëve, dhe kjo është në thelb mese e kuptueshme."

"Sa u përket dijetarëve, ata nuk do ta kundërshtojnë, për shembull, politikën e vaksinimit në Arabinë Saudite. Ata thjesht nuk do ta bëjnë këtë. Ky është përshtypja e përgjithshme që kam marrë nga disa studentë të dijes me të cilët kam folur në Medinë. Dhe ti po ashtu e din qe kjo eshte pershtypja e pergjithshme."

"Dijetari nuk do të fillojë ta cenoje atë politikë. Ky është përshtypja e përgjithshme që kam marrë nga disa studentë të dijes."

Lexuesi duhet të vërejë mungesën e ndershmërisë së Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī, sepse ai dhe ekipi i tij nuk zbuluan faktin se une thjesht po përcillja reagimet që kisha marrë nga studentët e dijes ,pasi pata diskutuar këtë çështje me ta.

Si pasoje kjo përbën mungesë të plotë ndershmërie dhe eshte gënjeshtër e hapur.

... كأنه رجل أمحق ... فالشيخ سامل حمتار متخبط بسبب حهله بالطب
وهذا عيل سبيل املثال فالشيوخ اجلهال غري املتخصصني كثر

09. "Sikur të ishte një budalla... Shejh Sālim është i hutuar dhe i çorientuar për shkak të padijes së tij në mjekësi... Ky është vetëm një shembull, sepse shumë shejhë jane të paditur ne fusha ku nuk janë specialistë."

Kjo është një nga shtrembërimet dhe shpifjet më të rënda e më të liga që mund t'i bëhen fjalëve dhe qëllimit të një personi.

Ata morën vetëm 30 sekondat e fundit nga një regjistrim privat prej pothuajse një ore, të zhvilluar me një person të vetëm. Gjatë gjithë atij regjistrimi unë po përpiqesha t'i shpjegoja se mosmarrëveshjet në çështjet mjekësore nuk i referohen dijetarëve fetarë, sepse mjekësia nuk është fusha e specializimit të tyre. Në atë moment më erdhi ndër mend diçka që ma kishte treguar një vëlla, dhe unë thjesht po citoja fjalët e tij: nëse ai do ta paraqiste para Shejh Sālimit çështjen e mospajtimit rreth vaksinave dhe dëmeve të tyre, ashtu siç kishte menduar të bënte, ndërsa më pas të tjerë do t'i paraqisnin pretendimin e kundërt, atëherë Shejhu nuk do ta dinte kë duhej të besonte.

Dr. ʿArafāt nuk sqaroi se unë po citoja fjalët e një personi tjetër. Për më tepër, duke e shkëputur atë fragment nga 45 minutat paraprake të regjistrimit, ai bëri që të humbiste plotësisht thelbi i asaj që po përpiqesha të shpjegoja gjatë gjithë bisedës. Më pas, ai u përqendrua te mënyra se si, sipas perceptimit të tij, unë flisja gjatë atij shpjegimi dhe pretendoi se po qeshja fjalë për fjalë me qëllim përçmues e tallës, vetëm për të krijuar një skandal të madh.

Fatkeqësisht, ai arriti të ndikojë tek shumë njerëz, veçanërisht tek folësit e gjuhës arabe, përmes këtyre ekzagjerimeve të rënda dhe interpretimeve tepër dashakeqe të qëllimit dhe synimit tim.

Duke parë prapa, ndoshta do të kishte qenë më mirë të mos e kisha përmendur fare këtë çështje. Megjithatë, siç e thashë, ajo më erdhi spontanisht në mendje dhe për këtë arsye e përmenda. Në rastin më të keq, kjo mund të konsiderohet si një pakujdesi në të folur.

Sa u përket të gjitha këtyre gënjeshtrave dhe shpifjeve të rënda që ka sajuar ʿArafāt, Allahu është Dëshmitar se unë jam i pastër prej tyre. Lus Allahun që ti japë ate qe meritojne shpifësve, gënjeshtarëve dhe zullumqarëve.

يريد من العالم أن لا يفتي في شيء حتى يتخصص فيه

10. "Ai dëshiron që dijetari të mos japë fetva për asnjë çështje derisa të jetë specialist në të."

Realiteti: Trillim dhe shpifje e pastër.

Autori thotë se nuk e ka thënë dhe as nuk e ka lënë të kuptohet ndonjëherë një gjë të tillë.

Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī ka ngatërruar çështjen e dhënies së fetvasë mbi dispozitat e Sheriatit me çështjen e kthimit të mosmarrëveshjeve te mjekesise mes mjekeve tek dijetarët fetarë.

Bindja ime është se, kur mjekët dhe shkencëtarët nuk bien dakord në çështje mjekësore, dijetarët fetarë nuk mund t'i zgjidhin ato mosmarrëveshje, përveç nëse vetë janë specialistë ose kanë njohuri të mjaftueshme në atë fushë.

Po kështu, një mjek ose specialist nuk ka nevojë për lejen e dijetarëve fetarë për të shprehur mendimin e tij profesional.

Ndërsa çështjet e **fikhut**, dispozitave të Sheriatit dhe fetvave që mund të lidhen me çështje mjekësore janë diçka krejt tjetër. Dhe në regjistrimet e mija zanore kam kështilluar të paktën dhjetë herë që njerëzit duhet t'u drejtohen dijetarëve .

Disa nga deklaratat e mija:

"...çështjet duhet t'i çoni tek dijetarët... kur dispozita islame për një çështje nuk është e qartë."

"Shkurtimisht, çfarëdo që dijetarët kanë këshilluar për Arabinë Saudite, unë bëj thirrje për bindje ndaj sundimtarëve. Mospajtimi ka përfunduar. Nuk kemi më asnjë mosmarrëveshje për bindjen ndaj sundimtarëve dhe dijetarëve."

"Çfarë thonë dijetarët në Arabinë Saudite? Kthehuni tek ata. Ata thonë: ndiqni atë që thonë sundimtarët. Prandaj, në përputhje me parimin e Sunetit, unë them: ndiqni sundimtarët dhe dijetarët.Pra perfundimi ka ndryshuar tani.pranddaj ska medyshje per kete pa pike dyshimi per ndjekjen e tyre "

"...nëse je i hutuar për situatën tënde, duhet të shkosh tek një dijetar dhe ti pyesësh për dispozitën islame të këtyre çështjeve."

"...duhet t'i paraqesësh dijetarit këto fakte dhe të sigurohesh që vendimi fetar të bazohet mbi faktet ."

"...dhe nëse dikush është i hutuar, mund të shkojë tek një dijetar."

Në përfundim, të gjitha pretendimet se une "i largoj njerëzit nga dijetarët", "përpiqem të rrëzojë autoritetin e dijetarëve" ose se kam thënë se "dijetarët nuk mund të japin fetva pa marrë më parë kualifikime mjekësore", janë qartësisht të pavërteta .Keto jane vetem shpifje të liga.

فكيف يتجنى صاحبه على العلماء ومكانتهم، فيصور العلماء كأنهم دراويش

11. "Si mund të sulmojë ai dijetarët dhe pozitën e tyre, duke i paraqitur sikur janë dervishë?"

Realiteti: Akuza të rreme të bazuara në imagjinatë të shfrenuar.

Kjo është ajo që Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī dhe ekipi i tij i përkthyesve dëshironin të shihnin në fjalët e mija, ndonëse aty nuk ekziston asgjë e tillë. Kjo eshte ekzagjerim dhe shtrembërim.dhe nerealitet Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī filloi të bënte pretendime të tilla të ekzagjeruara për të fituar simpati dhe mbështetje për kauzën e tij, duke ditur qe deshtoi dhe se qasja e tij e parë në shtator të vitit 2024 ishte kritikuar nga shumë njerëz.

Kjo mënyrë veprimi është shumë larg metodës së përgjigjeve dhe kundërshtimeve të bazuara në dije që njihen nga dijetarët e mëdhenj, si Shejh Rabīʿ bin Hādī, të cilët karakterizohen nga ndershmëria, drejtësia dhe integriteti.

Përkundrazi, këto janë gënjeshtra, trillime dhe propagandë nga Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī, i cili shpik domosdoshmeri logjike të pretenduara (lawāzim) dhe ua imponon ato fjalëve të njerëzve, duke ua atribuar padrejtësisht gjëra nga të cilat ata janë të pafajshëm.

Shënim: Rreth "Lāzimit" (pasojës ose nënkuptimit të një fjale)

Lexuesi duhet të ketë parasysh se dijetarë si Ibn Taymiyyah (Allahu e mëshiroftë), Ibn al-ʿUthaymīn (Allahu e mëshiroftë) dhe të tjerë kanë sqaruar çështjen e **lāzimit** (domosdoshmërisë ose implikimit) të një thënieje. Ata kanë shpjeguar se implikimi i një thënieje nuk mund t'i atribuohet gjithmonë një personi si të ishte vetë qëndrimi ose fjala e tij.

. Shaykh Ibn al-ʿUthaymīn shpjegon se ekzistojnë tri situata:

a) Kur një person e mohon dhe e refuzon që **lāzimi** i thënies së tij të jetë edhe thënia (qëndrimi) i tij.

b) Kur një person e pranon se lāzimi i thënies së tij është gjithashtu thenia qendrrimi i tij

c) Kur nuk dihet nëse ai e mohon apo e pohon (e pranon) lāzimin e thënies së tij, atëherë nuk lejohet t'ia atribuosh atij lāzimin e asaj thënieje. Ibn Taymiyyah ka thënë se kjo përbën gënjeshtër ndaj tij.

Ibn Taymiyyah ka thënë se atribuimi i lāzimit të një thënieje një personi, kur ai nuk e ka pranuar atë, përbën gënjeshtër ndaj tij.

Kështu, sipas ketij shembulli, kur në mesazhet e mia zanore, siç u përmend në pikën 8 më sipër, thashë se, për shkak të bindjes ndaj autoriteteve dhe zbatimit të Sunetit, një dijetar nuk do ta kundërshtojë **ixhtihadin** e sundimtarit në politikat e tij, veçanërisht në çështjet e kësaj bote ku ekziston mospajtim mes dijetarëve, Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī ka nxjerrë prej kësaj fjalimi një sërë **lawāzim** . Ai pretendon se unë kam thënë se dijetarët janë të paaftë dhe nuk guxojnë t'i kundërshtojnë sundimtarët nga frika e kështu me radhë, dhe me akuzon mua se po ndjek metodologjine e Quṭbisteve dhe Surūrive.

Dhe ky akuzim po hidhet edhe pse vete Shaykh al-Bukhārī ka thënë se: *"Nuk i lejohet dijetarëve të dalin jashtë mendimit të sundimtarëve"* dhe se ata nuk mund *"ta braktisin fjalën e tyre"*, në kontekstin e po të njëjtës çështje.

Sipas metodës së Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī dhe atyre që ndjekin qasjen e tij, atëherë do të ishte edhe më me vend që këto fjalë te sheikhut ne fakt të konsideroheshin si fyerje ndaj dijetarëve dhe si metodologji e **Quṭbisteve** dhe **Surūrive**.

Megjithatë, lexuesi i paanshëm e kupton saktësisht se çfarë është synuar me këto fjalë dhe nuk do të ushqente kurrë një shtrembërim kaq të rëndë dhe të neveritshëm të qëllimit (nijetit)

Prandaj, kjo nuk perben vërtetësi dhe qëndrueshmëri. Kjo është pikërisht ajo kundër së cilës kanë paralajmëruar dijetarët: që kritikat dhe refutimet të mos bazohen në padrejtësi dhe gënjeshtra, pasi kjo çon në sprova (fitne) dhe përçarje.

Dijetarët janë shumë larg përfshirjes në këtë lloj sjelljeje kur vlerësojnë, kritikojnë ose refutojnë thëniet.

فلهذا فكل متخصص خبير سيقول: لا حاجة لي أن أجلس إلى العلماء، ولا حاجة بي لفتاويهم في النوازل

12. "Prandaj, çdo specialist do të thotë: Nuk kam nevojë të ulem me dijetarët dhe nuk kam nevojë për fetvatë e tyre në çështjet e reja."

Realiteti: Fjale te ngaterruara dhe pa lidhje.

Kësaj akuze iu përgjigjan në përgjigjen e time të dytë në tetor 2024. Nuk ka thënë kurrë një gjë të tillë.

Por ajo qe kam thene është se, në çdo fushë të veçantë të jetës (si mjekësia, teknologjia, industria apo bujqësia), nuk është detyra e dijetarëve fetarë të zgjidhin mosmarrëveshjet midis specialistëve të asaj fushe.Dhe e shpjegova këtë sepse disa njerëz kërkonin që une t'ua paraqisja dijetarëve mendimet e mija klinike mbi trajtimin e sëmundjeve dhe vaksinimet. Dijetarët nuk janë gjyqtarë apo arbitra në mosmarrëveshjet mjekësore.

Ndërsa kur nevojitet një fetva për një dispozitë të Sheriatit, në regjistrimet zanore e kam bërë shumë të qartë se njerëzit duhet t'u drejtohen dijetarëve.

Prandaj, kjo akuzë është një trillim dhe shpifje e pastër, e bazuar në konfuzimin e vete Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī. Ai deshiron te besoje se kjo eshte ajo cfare thashe une dhe me deshperim gjithashtu deshiron qe dhe te tjeret te besojne te njejten gje

---

ما الفرق بين هذا الكلام وبين قول السرورية والقطبية: العلماء الكبار لا يفقهون الواقع؟

13. "Cili është dallimi midis kësaj fjale dhe thënies së Sururijve dhe Kutbijve se dijetarët nuk e kuptojnë realitetin bashkëkohor?"

Realiteti: Pra, në thelb, ju thjesht shpikni gjëra, ua atribuoni ato njerëzve dhe më pas bëni komente si ky. Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī dhe përkthyesit e tij e kanë tejkaluar kompetencën e tyre dhe e kanë futur veten në një labirint me të gjitha këto shtrembërime, gënjeshtra dhe trillime, të bazuara në qëllimet e tyre të dyshimta.

Ibn al-Qayyim (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: [6]

والكلمة الواحدة يقولها اثنان يريد منها أحدهما أعظم الباطل ويريد بها الأخر محض الحق، والاعتبار بطريقة القائل وسيرته ومذهبه وما يدعو إليه، وما يناظر عليه

"Një fjalë mund të thuhet nga dy njerëz; njëri synon me të gënjeshtrën më të madhe, ndërsa tjetri synon të vërtetën e pastër. Prandaj duhet parë rruga e folësit, metodologjia e tij, medhhebi i tij, ajo që ai thërret dhe argumentet që paraqet."

Nëse kjo është kështu në lidhje me një thënie që një njeri e ka thënë vërtete, atëherë ç'të thuhet për thëniet që trillohen dhe i atribuohen atij?!

Me mirësinë e Allahut, unë jam një **Selefi** që prej më shumë se 30 vitesh kam thirrur në **Kuran** dhe **Sunet** sipas rrugës së **Selefëve**, kam thirrur në kthimin te dijetarët e **Sunetit**, si dhe kam refuzuar (bërë refutime ndaj) **Havarixhëve** dhe manifestimete tyre në kohët moderne, si **Surūrite** dhe **Quṭbistet**.

Nuk keni asnjë justifikim që të keni arritur në përfundimin se unë i ngjaj **Ehlu'l-Bidʿah** (pasuesve të bidatit), përveç nëse jeni mashtruar duke besuar gënjeshtra, ose ju thjesht keni zgjedhur vete të jeni të padrejtë dhe shtypës, pasi jeni vënë në dijeni se fjalët tuaja përmbajnë gënjeshtra dhe padrejtësi.

ولا يمكنهم اتخاذ قرار في هذا المجال

14. "Ata nuk janë në gjendje të marrin një vendim në këtë ceshtje."

Realiteti: Kjo është shkëputje dhe vendosje e fjalës jashte kontekstit te saj (**batr al-kalām**). Është një formë mashtrimi dhe mungese ndershmërie. ʿArafāti e paraqiti këtë të shkëputur nga konteksti i saj për t'i shërbyer trrillimit që po përpiqet të ndërtojë rreth meje. Në të vërtetë, kjo thënie ishte, edhe një herë, në lidhje me faktin se dijetarët e fesë janë specialistë në shkencat e fesë (**dīn**), e jo në mjekësi, dhe për këtë arsye nuk janë ata që zgjidhin mosmarrëveshjet në çështjet e mjekësisë. Kaq ishte.

https://abuiyaad.com/a/scholars-medicine-specialists (**Dijetarët u referohen specialistëve në çështjet e mjekësisë)**

Deri tani, lexuesi duhet të jetë në gjendje të shohë një prirje dhe motiv të qartë. Ata po bëjnë shtrembërime dhe përgjithësime të gjera nga fjali që i kanë shkëputur nga konteksti i tyre dhe më pas po më vënë në gojë fjalë që nuk i kam thënë, përmes këtyre shtrembërimeve dhe paraqitjeve të gabuara të asaj që kam thënë dhe kam pasur për qëllim.

وقد سبق أن أفتى أن التباعد بين المصلين شِرك أصغر

15. "Më parë ai kishte dhënë një fetva se distancimi midis falësve në namaz është shirk i vogël."

Realiteti: Një tjetër shtrembërim dhe trillim. Megjithëse Arafati vetëm e la të kuptohet dhe nuk përmendi asnjë emër, ka shumë tregues (**qarāʾin**) dhe prova që tregojnë se ai po i referohet mua.

Duket se ai po pushtohet nga emocionet, dhe si rrjedhojë fjalimi i tij bëhet i coroditur dhe pa lidhje. Nëse ai ne te vertete po me referohet mua, atëherë kjo, edhe një herë, nuk është e vërtetë. Unë nuk kam dhënë kurrë një **fetva** ku të deklaroj se njerëzit që mbajnë distancë gjatë namazit kanë rënë në **shirk të vogël (shirk al-aṣghar)**. Po ashtu, nuk i kam akuzuar dijetarët dhe ata që ndjekin fetvatë e tyre, sipas të cileve namazi mbetet i vlefshëm pavarësisht kësaj distance, se kanë rënë në shirk të vogël.

Unë kam dhënë paralajmërime lidhur me mbështetjen në shkaqet mbi Allahun (**al-iʿtimād ʿalā al-asbāb**), si dhe lidhur me mbajtjen e distancës mes njerëzve të shëndetshëm dhe pa sëmundje, pa një arsye të justifikueshme, pasi kjo është një formë e **vesveseve (waswasah)**, e teprimit (**ghuluww**) dhe e ushqimit të bestytnive (**taṭayyur**), siç e kanë përmendur **Ibn Rajab**,

Sulaymān bin Ḥamdān, **al-Albānī** dhe **Ibn al-ʿUthaymīn** (https://abuiyaad.com/sn/contagion-precaution-limits). Këtë e kam sqaruar më gjerësisht në shkrime të tjera të miat, por ka nga ata që e keqkuptojnë qëllimisht për shkak të synimeve e tyre të këqija, ose më pafajësisht për shkak të përtacisë për të lexuar, ose ndoshta për arsye të tjera.

Sa i përket rastit kur një person mban distancë nga njerëzit që janë realisht të sëmurë, ose e bën këtë në bindje ndaj sundimtarëve dhe për të shmangur përçarjen, unë gjithmonë kam urdhëruar per bindjen ndaj sundimtarëve.

Megjithatë, Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī e paraqiti këtë në mënyrë mashtruese, dhe e beri te dukej sikur unë po i akuzoja sundimtarët, dijetarët dhe të gjithë të tjerët për **shirk**. Kjo është pandershmëri akademike dhe intelektuale, shumë larg çdo debati dhe diskutimi të bazuar në dije mbi këtë çështje. Ky është një tjetër pretendim i rremë, që synon t'i tronditë njerëzit dhe të fitojë simpatinë e tyre për kauzën e tij.

وتسقط فتاويهم في النوازل

16. "[Që kështu] të zhvlerësohen fetvatë e tyre në kohë krizash."

Realiteti: Gënjeshtër e plotë. Unë e kam pohuar vazhdimisht dhe në mënyrë të qëndrueshme domosdoshmërinë e kthimit te dijetarët në çështjet e adhurimit dhe të marrëdhënieve (muʿāmalāt) që ndikoheshin nga masat parandaluese te covidit në fuqi. Sa u përket masave dhe politikave shëndetësore, ato janë pjesë e vendimeve të sundimtarëve, dhe unë kam shpjeguar shumë herë se si dijetarët, ashtu edhe nënshtetasit, e kanë për detyrë t'u binden atyre në këtë aspekt.

Ka pasur dijetarë që nuk ishin dakord në këto çështje, qoftë tërësisht (si **Shaykh al-Luḥaydān**),(https://abuiyaad.com/a/luhaydan-swine-flu-virologist/print) ose pjesërisht, sic jane ata dijetarët që nuk ishin dakord me distancimin shoqëror, por që gjithsesi bëne thirrje për bindje ndaj sundimtarit. Pikërisht për këtë kam bërë thirrje edhe unë.

E falënderoj vëllanë që e shkroi këtë dokument të shkëlqyer (“The Covid Narrative”), i cili e shpjegon këtë çështje në mënyrë shumë të qartë, duke u mbështetur në burime zyrtare qeveritare. Në thelb, ky dokument përbën një verifikim empirik të realitetit që unë e kam shpjeguar që në fillim të vitit 2020, me synimin për të vendosur një mburojë mbrojtëse rreth dijetarëve, në mënyrë që ata të mos fajësoheshin për ndonjë nga pasojat e dëmshme të masave kontroversale te marra, të cilat ishin të pabazuara shkencërisht, si edhe të injeksioneve eksperimentale.

https://abuiyaad.com/d/covid-narrative-muzammil

يوالي ويعادي فيها

17. "Ai tregon besnikëri dhe armiqësi mbi bazën e këtyre çështjeve."

Realiteti: Kko nuk eshte e vertete . Eshte genjeshter . Shkrimet e mia ishin kryesisht një përgjigje ndaj pretendimeve të gabuara që po përhapeshin nga disa studentë të dijes, ndaj teprimeve në të cilat po binin, si dhe ndaj atribuimeve të gabuara qe ata po ia mveshnin disa prej dijetarëve.

Unë nuk e detyrova askënd të pranonte pikëpamjet e mia. Megjithatë, unë diskutova çështje të ndryshme – fetare, shkencore dhe mjekësore – duke u mbështetur në dije dhe argumente, si pjesë e kundërpërgjigjes ndaj këtyre pretendimeve të gabuara.

Mesa duket ata nuk ishin në gjendje t'u përgjigjeshin në thelb dijes dhe argumenteve të paraqitura, prandaj iu drejtuan mjeteve të tjera për të më heshtur.

يشغل الشباب ليل نهار بهذا المسألة

18. "Ai i mban të rinjtë të zënë ditë e natë me këtë çështje."

Realiteti: Kjo është e pavërtetë; është gënjeshtër.

Përmbledhje

Në shtator të vitit 2024, Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī përhapi në rrjetet sociale një numër të madh gënjeshtrash, trillimesh dhe shtrembërimesh, të bazuara në mesazhe zanore private të dërguara një personi të caktuar në maj të vitit 2021. Kur iu kërkua t'i publikonte mesazhet zanore mbi të cilat po bazonte akuzat e tij, ai refuzoi t'i jepte ato. Ai gjithashtu refuzoi të zbulonte identitetin e përkthyesve të tij. Kjo nuk është metoda e njerëzve që janë mbi të vërtetën dhe ndjekin rrugën e **Ehlu'l-Hadithit**, ku refuzohet zbulimi i burimit dhe nuk bëhen të njohur transmetuesit (në këtë

rast, përkthyesit). Kjo është mënyra e njerëzve të së kotës, të cilët kanë diçka për të fshehur dhe po veprojnë me shtrembërim.

Ka pasur disa etapa nëpër të cilat ai kaloi:

01. Faza e publikimit të gënjeshtrave, trillimeve dhe shtrembërimeve të hapura.

02. Kur iu kërkuan mesazhet zanore dhe provat për pretendimet e tij, ai filloi të kërkonte një pajtim (**ṣulḥ**) dhe një arbitrazh/gjykim (**muḥākamah**), duke e paraqitur në mënyrë mashtruese çështjen sikur të ishte një mosmarrëveshje personale.

03. Duke qenë i paaftë të paraqiste provat kur iu kërkuan, ai dhe përkthyesit e tij iu kthyen sërish mesazheve zanore për të ndërtuar gënjeshtra të reja. Pretendimi i radhës ishte se unë paska thënë: **"Një dijetar nuk mund të japë fetva në çështje mjekësore, përveç nëse bëhet vetë specialist dhe pajiset me kualifikimet përkatëse."** Unë e hodha poshtë këtë gënjeshtër dhe edhe kjo përpjekje dështoi.

https://abuiyaad.com/d/undztv

04. Më pas ai përdori taktikën e shpifjes, duke pretenduar se unë paskam folur keq për një shejh, ndërkohë që në të vërtetë unë po citoja fjalët e një personi tjetër për të ilustruar pikërisht faktin se dijetarët nuk i zgjidhin mosmarrëveshjet mjekësore mes njerëzve, sepse kjo nuk është fusha e tyre.

05. Në këtë periudhë të parë ai dështoi; njerëzit e kritikuan dhe nuk i pranuan këto veprime, kështu që ai humbi një pjesë të besueshmërisë dhe u pikëllua për këtë. Në atë kohë unë vura në dukje se ai nuk do të hiqte dorë, por do ta rishikonte strategjinë e tij dhe do të kthehej përsëri, gjë që edhe bëri.

06. Pas disa muajsh, në shkurt, ai nisi një fushatë krejtësisht të re, por këtë herë duke përdorur ndërmjetës, në mënyrë që t'i mbante duart e veta sa më të pastra të ishte e mundur. Ai u përpoq të depërtonte në thirrjen (**daʿwah**) në gjuhën angleze përmes këtyre ndërmjetësve. Kjo fushatë e re marketingu filloi kur njëri prej tyre publikoi një përkthim në arabisht të transkriptit të mesazhit të shkurtër zanor prej 8 minutash, të njëjtit mesazh për të cilin unë kisha kërkuar sqarim për gati një vit më parë dhe të cilin ai kishte refuzuar ta jepte. Tani, papritur, ata e hodhën në rrjetet sociale, gjashtë muaj pasi e patem kërkuar, dhe më pak se një vit para se unë të mësoja për te dhe të bëja përpjekje për ta marre prej tyre.

07. Taktika e re e përdorur nga Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī — në përpjekje për t'u distancuar nga gënjeshtrat, trillimet dhe shpifjet fillestare — ishte përdorimi i thënieve të shkëputura nga konteksti i mesazhit zanor në fjalë. Izolimi dhe paqartësia e te cilave lejuan nxjerrjen e përgjithësimeve . Prej tyre u nxorën shprehje si: **"Ata nuk do t'u kundërvihen sundimtarëve"**, **"Ata nuk do t'u kundërvihen politikave shëndetësore"** dhe të ngjashme, të cilat u paraqitën në mënyrën më të keqe të mundshme dhe u vendosën në të njëjtën kategori me fjalët e **Quṭbisteve** dhe **Surūririve**.

08. Më pas, disa ditë më vonë, më 16 shkurt 2025, unë publikova transkriptin e plotë (nga një audio pothuajse një orë e gjatë), dhe po ashtu dhe një herë gënjeshtrat dhe shtrembërimet e tyre u zbuluan, ndërsa njerëzit nuk i besuan më dhe i kuptuan qartë manovrat e tyre.

09. Ende i pakënaqur, Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī i nxiti ndjekësit e tij nga Australia, Gjermania dhe vende të tjera që të fillonin të publikonin materiale në internet, si pjesë e një fushate të organizuar. Qëllimi i kësaj ishte krijimi i presionit, një formë frikësimi dhe intimidimi.

Aktualisht, Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī është në kulmin e kësaj faze të fushatës së tij, e cila filloi në shkurt, vazhdoi gjatë Ramazanit 1446 (mars 2025) dhe ende po vazhdon me të edhe tani. Qëllimi i tyre është të bëjnë **tabdīʿ** ndaj meje, të më nxjerrin nga **Selefizmi (Salafiyyah)** dhe më pas t'i vënë njerëzit në provë (**imtiḥān**) në këtë çështje, për të parë se në cilën anë qëndrojnë.

Në të vërtetë, ata tashmë po e bëjnë këtë në disa vende evropiane dhe janë të gatshëm ta copëtojnë vetë thirrjen e tyre (**daʿwah**) gjatë këtij procesi, pavarësisht dobësisë së tyre dhe faktit se në qytetet e tyre janë të mbizotëruar nga **Ḥizbiyyīnët**. Kjo nuk është prej urtësisë dhe, sigurisht, kjo nuk është rruga e dijetarëve **Rabbānī**, si Shaykh Rabīʿ bin Hādī dhe Shaykh ʿUbayd.

Me pak fjalë: Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī është një individ pa skrupuj, i cili ndez fitnen dhe i hedh benzinë zjarrit të saj. Ai nuk i posedon tiparet dhe sjelljet e njerëzve të dijes (pavarësisht se konsiderohet si dikush që mbart dije), dhe nuk ka shfaqur as edhe një grimë integriteti intelektual dhe akademik në fushën e citimit me ndershmëri dhe të kritikimit me drejtësi, sinqeritet dhe pastërti qëllimi.

Përkundrazi, ai përhapi gënjeshtra, bëri ekzagjerime të mëdha dhe këmbënguli në to edhe pasi u këshillua nga njerëz të tjerë. Ai u angazhua në skema dhe plane duke mobilizuar përfaqësuesit dhe njerëzit e tij për të sulmuar në internet , për të ngacmuar dhe frikësuar të tjerët, në mënyrë që të arrinte qëllimin e tij, pa u shqetësuar për pasojat e veprimeve të tij të papërgjegjshme dhe të dëmshme, të cilat janë shumë larg nga rruga e dijetarëve.

Më pas, ai i manipulon selefitë duke u shfaqur sikur bën thirrje për bashkim, dashuri dhe durim, dhe për të qenë të sjellshëm e të butë me selefitë, jo të ashpër, duke krijuar përshtypjen sikur ai është shembulli i kësaj sjelljeje, ndërkohë që veprat e tij bien plotësisht në kundërshtim me atë që ai thotë.

Të gjithë njerëzit e paanshëm dhe të ndershëm mund ta njohin dhe ta shohin qartë këtë.

Burimet

Më poshtë gjenden disa burime që lidhen me këtë çështje. Burimi i parë është një seri kundërpërgjigjesh që kam bërë në tetor të vitit 2024. Burimi i dytë është një transkript i plotë i mesazheve zanore në fjalë. Ata lane jashtë mesazhin e parë zanor, i cili ishte rreth 45 minuta i

gjatë dhe që i rrëzon gënjeshtrat dhe shtrembërimet e tyre, dhe janë mbështetur vetëm në mesazhin zanor më të shkurtër, prej 8 minutash.

Burimi i tretë është një përgjigje e detajuar ndaj dyshimeve të tyre dhe përfshin një sfond të rëndësishëm si dhe historikun kronologjik të ngjarjeve. Burimet e katërt dhe të pestë përmbajnë fjalë të Shaykh Ṣāliḥ al-Luḥaydān (Allahu e mëshiroftë), pikëpamjet e të cilit në këto çështje i konsideroj të jenë të vërteta.

Për referencë, më poshtë gjendet edhe një dokument i detajuar kronologjik i pretendimeve dhe akuzave të përhapura nga ʿArafāt në rrjetet sociale, i cili është përgatitur nga një person tjetër.

01. Lidhur me atë që është përhapur në rrjetet sociale nga akuzat
https://abuiyaad.com/a/response-allegations

Katër artikujt e parë që kërkojnë prova për pretendimet dhe akuzat e ndryshme të përhapura nga ʿArafāt në rrjetet sociale.

Part 1: https://abuiyaad.com/d/rnbutj ANGLISHT ....
https://abuiyaad.com/d/lamxef ARABISHT

Part 2: https://abuiyaad.com/d/undztv ANGLISHT ....
https://abuiyaad.com/d/ssefdt ARABISHT

Part 3: https://abuiyaad.com/d/ofnmgw ANGLISHT .....
https://abuiyaad.com/d/ixursq ARABISHT

Part 4: https://abuiyaad.com/d/mrfpei ANGLISHT.....
https://abuiyaad.com/d/nraddr ARABISHT

02. Transkripti i mesazheve zanore

https://abuiyaad.com/d/transcript-audio-abuiyaad-english (transkriptim i 45 minutave)

https://abuiyaad.com/d/fpeoxv (Permbledhje e shkurter 2 faqe)

https://abuiyaad.com/d/abuiyaad-transcript-summary-arabic (2 faqet ne arabisht)

03. **Mbrojtja e sundimtarëve dhe dijetarëve mbi bazën e domosdoshmërive të dijes.**
Një përgjigje ndaj 21 dyshimeve lidhur me disa mesazhe zanore private.

https://abuiyaad.com/a/response-doubts-audios/print

04. Shaykh Ṣāliḥ al-Luḥaydān: "Gripi i derrit" nuk ekziston dhe është i sajuar për qëllime komerciale.
Shaykh-u shpjegoi se interesat tregtare përdorin përhapjen e frikës për të shitur vaksina.

https://abuiyaad.com/a/luhaydan-swine-flu-virologist/print

05. Shaykh Ṣāliḥ al-Luḥaydān në lidhje me koronavirusin.
Shaykh-u shpreh dyshime rreth koronavirusit në të njëjtën mënyrë siç bëri në lidhje me "gripin e derrit"

https://abuiyaad.com/a/luhaydan-coronavirus/print

06. Shaykh al-Albānī duke sqaruar qëllimin e Ibn Taymiyes në lidhje me natyrën e epërsisë së arabëve në llojin e tyre.

https://abuiyaad.com/d/sdyldy

07. Shaykh al-Islām Ibn Taymiyyah duke diskutuar hadithin e pjalmimit të palmave të hurmave.

https://abuiyaad.com/d/ibn-taymiyyah-pollination

Përditësim: Sqarim më 10 maj 2025

Krejtësisht të ndara nga të gjitha këto veprime të dëmshme të Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī dhe ndjekësve të tij, të cilat janë në kundërshtim me metodologjinë Selefite, unë ua dërgova mesazhet e mia zanore një shejhu për t'i shqyrtuar dhe ai ua përcolli ato një numri njerëzish që t'i ekzaminonin.

Disa prej tyre thanë se nuk gjetën në to asgjë që të përbënte fjalë të pahijshme ndaj dijetarëve dhe nuk pati asnje mospajtimpajtim mes tyre se nuk kishte ndonjë fjalë të keqe ndaj dijetarëve.

Shejhu gjithashtu shpjegoi se, gjatë përkthimit nga një gjuhë në një tjetër, qëllimi mund të ndryshohet për shkak të ndryshimeve në zakone, tonin e të folurit, dialektin dhe kontekstin kulturor të folësit. Prandaj, mesazhi zanor nuk mund të vlerësohet dhe të gjykohet përveçse në gjuhën e tij origjinale, atë angleze, nga folës amtarë të saj.

Megjithatë, nga këndvështrimi i lëshimit pe (**tanāzūl**), me qëllim që të qartësohet çështja, t'u hiqet atyre baza për të vazhduar me këto pretendime dhe t'i jepet fund fitnes së këtyre njerëzve, unë sqarova disa çështje të pakta që ishin ngritur si të nevojshme për këtë qëllim.

Këtë sugjerim dhe këshillë e mora më 6 maj 2025.

Gjithashtu, një shejh tjetër, të cilit po ashtu ia kisha dërguar mesazhet e mia zanore, tha se ndaj meje ishin thënë gënjeshtra dhe se isha trajtuar me padrejtësi, si dhe se disa njerëz po përpiqeshin të më rrëzonin. Ai i përqeshi ata për paaftësinë e tyre për të kuptuar pikën se mosmarrëveshjet

dhe dallimet në mjekësi nuk u drejtohen dijetarëve të Sheriatit, dhe e quajti atë që kërkoi një gjë të tillë **budalla (aḥmaq)**.

Ky sqarim nuk ka asnjë lidhje me shtrembërimet, trillimet dhe shpifjet e Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī, dhe as me veprimtaritë e nxënësve dhe përfaqësuesve të tij nëpër botë. Ky sqarim lidhet me një zinxhir krejtësisht të veçantë ngjarjesh dhe ka një konsideratë krejt tjetër.

Do t'i shihni këta njerëz duke filluar të gëzohen, në mashtrimin e tyre, duke menduar se kanë arritur një fitore dhe se më kanë detyruar të pendohem nga gënjeshtrat dhe trillimet për të cilat më akuzuan, ndërkohë që realiteti është krejt ndryshe.

Mund ta lexoni sqarimin dhe shënimet shpjeguese mbi çështjen:

Deklaratë sqaruese – 10 maj 2025

https://abuiyaad.com/d/ai-clarification

Shënime mbi deklaratën sqaruese të 10 majit 2025.

https://abuiyaad.com/d/ai-clarification-notes

Çështjet që kam sqaruar:

01. Kam bërë një vërejtje të rastësishme lidhur me gjendjen e dietës, shëndetit dhe kërkimeve mjekësore në shtetet e Gjirit, në kontekstin e zhvillimit të tyre të shpejtë dhe mbështetjes së tyre në ekspertizën e huaj. Kjo u mor si diçka fyese dhe shkaktoi lëndim të ndjenjave. Megjithatë, edhe pse nuk kisha asnjë dijeni paraprake se si Dr. ʿArafāt al-Muḥammadī dhe ndjekësit e tij do ta përdornin atë mesazh zanor 3 ose 4 vite më vonë, ndoshta do të kishte qenë më mirë të mos e kisha përmendur.

02. Edhe pse fjala ime se dijetarët nuk i zgjidhin mosmarrëveshjet mjekësore mes njerëzve lidhur me mënyrën e trajtimit të një sëmundjeje ose me vaksinimet, pasi kjo nuk është fusha e tyre e veprimtarisë, është e saktë në vetvete, dikush mund të nxjerrë nga fjalët e mia (përmes keqinterpretimit) se dijetarët nuk kanë aftësi personale dhe private për të njohur dhe për të folur rreth çështjeve mjekësore. Unë kurrë nuk kam thënë apo synuar diçka të tillë, prandaj e kam sqaruar këtë.

03. Edhe pse fjala ime lidhur me bindjen e dijetarëve ndaj sundimtarit në **ixhtihadin** e tij në lidhje me politikat shëndetësore (në çështjet ku ka mospajtim), dhe se kjo bindje bëhet nga këndvështrimi i Sunetit, është e vlefshme dhe e saktë, dikush mund të nxjerrë nga fjalët e mia (përmes keqinterpretimit) se dijetarët nuk i kundërshtojnë kurrë asnjë politikë të sundimtarëve. Kjo është qartazi diçka që unë kurrë nuk e kam thënë dhe as nuk e kam synuar. Prandaj, e kam sqaruar këtë.

04. Gjithashtu, e bëra të qartë se unë nuk flas keq për dijetarët dhe se kurrë nuk e kam bërë një gjë të tillë. Po ashtu, përsërita atë që kam mbajtur gjithmonë si qëndrim, që nga fillimi: në çdo

vend, njerëzit duhet t'u binden autoriteteve të tyre, rregullave dhe politikave të vendit të tyre, ndërsa për gjykimet legjislative që lidhen me çështjet e adhurimit dhe marrëdhënieve (muʿāmalāt) të prekura nga masat e reagimit ndaj pandemisë, ata duhet t'u drejtohen dijetarëve.

Me bërjen e këtij sqarimi, unë nuk i kam ndryshuar pikëpamjet dhe bindjet e mia lidhur me reagimin ndaj pandemisë së COVID-19, masave të pabazuara shkencërisht dhe injeksioneve eksperimentale të dëmshme dhe të dështuara. Gjithashtu, nuk kam pranuar dhe as nuk kam rënë dakord me asnjë nga trillimet dhe shpifjet që janë përhapur ndaj meje, si ato të përmendura më sipër. Këto mbeten trillime dhe shpifje dhe duhet të tërhiqen.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: [7]

Kushdo që debaton me të pavërtetën, duke e ditur se ajo është e tillë, do të mbetet nën zemërimin e Allahut derisa të heqë dorë prej saj. Dhe kushdo që thotë për një besimtar diçka që nuk është e vërtetë, Allahu do ta bëjë atë të banojë në lëng të ndyrë — [lëngu dhe qelbi i banorëve të Zjarrit] — derisa të heqë dorë nga ajo që ka thënë.

Shaykh Rabīʿ bin Hādī (Allahu e meshirofte) ka thënë: [8]

والله أنا لا أتخيل سلفيا يكذب

Betohem në Allahun, nuk mund ta imagjinoj një Selefi që gënjen.

Shaykh Rabīʿ bin Hādī (Allahu e meshirofte) ka thënë: [9]

فإن الكذب لقبيح وشنيع في غاية من القبح والشناعة شرعا ، وعقلا وفطرة وممقوتا لدى الأمم جميعا وفي الملل والنحل كلها ، قد حرّمه الله في الرسالات كلها ، وذم الكذب والكذابين في آيات كثيرة وتوعدهم أشد الوعيد

Me të vërtetë, gënjeshtra është e shëmtuar dhe e neveritshme, me shkallën më të lartë të shëmtisë dhe neverisë, sipas Sheriatit (**shar**ʿ), arsyes (ʿ**aql**) dhe natyrshmërisë së pastër (**fiṭrah**). Ajo është e urryer nga të gjitha kombet dhe nga të gjitha sektet fetare në tërësinë e tyre. Allahu e ka ndaluar atë në të gjitha mesazhet e shpallura dhe e ka dënuar gënjeshtrën dhe gënjeshtarët në shumë ajete, si dhe i ka kërcënuar ata me paralajmërimin më të rëndë.

Shaykh Rabīʿ bin Hādī (Allahu e ruajttë) u pyet: [10]
"A lejohet të gënjehet ndaj pasuesve të bidateve dhe të tjerëve nga njerëzit e devijimit?"

Ai u përgjigj:

Nuk lejohet të gënjesh ndaj jobesimtarëve, as ndaj njerëzve të bidatit dhe as ndaj askujt tjetër. Nuk lejohet të shpifësh ose të trillosh ndaj askujt, duke thënë: "Filani ka këtë dhe atë (të metë) tek ai", ose "ky grup (**xhemāʿah**) ka këtë dhe atë (të metë)". Kërkojmë mbrojtjen e Allahut, kjo nuk është e lejuar.

Ne sqarojmë devijimet që ata kanë; i citojmë ato fjalë për fjalë nga librat e tyre ose përmes mënyrave të tjera, pastaj i diskutojmë ato në mënyrë shkencore (**nunāqishuhā ʿilmijjan**) dhe kritike. Kjo është ajo që bëjmë ne dhe i lutemi Allahut që të gjithë selefitë ta ndjekin këtë metodë.

Ne nuk e konsiderojmë kurrë të lejuar një gjë të tillë. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut; ne nuk e konsiderojmë kurrë të lejuar që një musliman të trillojë gënjeshtra kundër një muslimani ose kundër një jobesimtari, në asnjë rast.

Një person mund të falet nëse gabon dhe transmeton gjëra që nuk janë të vërteta pa e ditur, por pasi çështja t'i jetë bërë e qartë dhe ai vazhdon të këmbëngulë e nuk tërhiqet nga këto gënjeshtra dhe trillime, atëherë ai nuk ka më asnjë justifikim dhe hyn në radhët e gënjeshtarëve.

Për më shumë rreth gënjeshtrës, kur dhe si një person konsiderohet gënjeshtar, si dhe për pasojat e saj të këqija, shih:

Përkufizimi i gënjeshtrës (Kadhib) dhe format e saj

https://abuiyaad.com/q/lying

Ibn al-Qayyim mbi natyrën e gënjeshtrës si diçka që në vetvete sjell prishje

https://abuiyaad.com/q/lying-corruption

Shënime në fund të faqes

1. Minhāj al-Sunnah (4/337).
2. Majmūʿ al-Fatāwā (20/84).
3. Majmūʿ Kutub wa Rasāʾil (10/401).
4. Majmūʿ Kutub wa Rasāʾil (12/380).
5. Al-Fuṣūl al-Maḍiyyah Min Sīrah al-Shaykh Rabīʿ (p. 147).
6. Madārij al-Sālikīn (3/521).
7. Ṣaḥīḥ Sunan Abī Dāwūd (no. 3597).
8. Al-Fuṣūl al-Maḍiyyah (p. 146).

9. Në ligjëratën **“Rreziku i gënjeshtrës dhe pasojat e saj të këqija”** ne https://rabee.net.
10. Ne regjistrrimin e kasetes: Taqwā Allāh wal-Ṣidq, e cila eshte ne faqen , https://rabee.net.

Publikuar: 17 Apr 2025